




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 13.05.2024

Kodi i ZRRE-së: V\_2018\_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Nr. 481129  
Data. 30-05-24

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullës Per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji;
- Metodologjinë e Taksave te Kyçjes të Rrjetit te shpërndarjes;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_2533\_04\_24 i dt.24.04.2024;

në seancën e mbajtur më datë 13.05.2024 nxori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** ankesa e aplikuesit Endrit Efendija, True Group SH.P.K nga Komuna e Gjakovës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. KEDS** duhet te beje revidimin e Pëlqimit elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike nr. 9387 datë 11.10.2023 sipas kërkesës se konsumatorit
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**A r s y e t i m**

Aplikuesi Endrit Efendija, True Group SH.P.K me datë 20.11.2023 ka paraqitur ankesë pranë DMK-së në ZRRE duke kontestuar përgjigjen e KEDS-it nr. 10219 datë 13.11.2023, me të cilën është refuzuar kërkesa e tij për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me Pëlqimin Elektroenergjetik dhe Zgjidhjen Teknike me nr.9387 dt. 11.10.2023.

Investitori Endrit Efendija, True Group SH.P.K ka aplikuar per pëlqim elektroenergjetik ne KEDS per objektin afarist si dhe ka dorëzuar projektin elektrik. Sipas përmbledhjes se projektit vërtetohet se kërkesa per fuqi maksimale te njëkohshme per 28 njësi është Pmnj=144 kW(sipas projektit elektrik).

**Provë:** Pëlqimi elektroenergjetik dhe Zgjidhja Teknike nr. 9387 datë 11.10.2023



Me datë 11.10.2023 KEDS ka lëshuar PEE dhe Zgjidhjen teknike nr. 9387 ku ka theksuar se: Bazuar ne te dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar per veprimtarin afariste:

Objekt banesor, 28 njësi, Fuqia e transformatorit  $S_{int}=160$  kVA me fuqi maksimale te njëkohshme prej  $P_{mnj}=144$  kW(sipas projektit elektrik). Ne PEE dhe ZT po ashtu janë përcaktuar edhe kushtet teknike te kyçjes si dhe mënyrës se furnizimit te aplikuesit. Sipas Zgjidhjes teknike, furnizimi i trafostacionit ri me energji eklektike bëhet nga dalja "Elektrokosova me kod:81084020" nga NS 35/10(20) kV "Gjakova III". Ekzekutimi i kyçjes trafostacionit te ri të realizohet atë mënyrë që kablo ekzistuese prehet vendin e paraqitur në zgjidhjen teknike faqe 3 dhe e njëjta te tërhiqet deri te kthina dalëse e trafostacionit te ri. Nga kthina hyrëse e trafostacionit te ri realizohet linja e re me kablo te tipit XHE 49A 3x1x150 mm<sup>2</sup> deri te kthina dalëse e trafostacionit "Ts-9 me kod: përmes kanalit kabllorik me gypa dhe puseta sipas normave teknike dhe projektit elektrik te aprovuar nga Departamenti i Investimeve —KEDS. Trafostacioni ri TS 10(20)/0.4 kV duhet të jetë me fuqi instaluese  $S_n=160$  kVA i tipit "Blindë Metalike ose Murosor" me te gjitha pajisjet adekuate per këtë tip të trafostacionit dhe i ndërtuar vend te përshtatshëm me mundësi te qasjes së përhershme...

**Provë:** Pëlqimi elektroenergjetik dhe Zgjidhja Teknike nr. 9387 datë 11.10.2023

Me datë 25.10.2023 Investitori **Endrit Efendija, True Group SH.P.K**, ka parashtruar kërkesë ne KEDS qe te i behet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 9387 datë 11.10.2023. Aplikuesi ne kërkesën e tij po ashtu ka bashkangjitur edhe njoftimin e lëshuar nga Drejtoria per Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit, KK Gjakove lidhur me kërkesën e aplikuesit per zhvillimin e punimeve sipas ZT nr. 9387 datë 11.10.2023 e cila është refuzuar me arsyetimin se aktualisht po punohet nga kompania rajonale K.R.U. Gjakova në projektin: Eliminimi i Ujërave të ndotura në Jug-Perëndim të Kosovë faza e III-të — Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit ti kanalizimeve te Gjakovës, ku gjatësia e kolektorit kryesor është 3.0 km me profil DN 300 deri DN 400 dhe ne këtë projekt është e përfshirë edhe rruga ARSIM RAMA dhe në segmentet ku ky kolektor kalon nëpër trotuare të ngarkuara me infrastruktura të shumta të cilat mund te pengojnë realizimin e tij, rekomandohet të behet zhvendosja e kolektorit në shiritin e rrugës andaj ekzekutimi i kanalit nëntokësor elektrik sipas kërkesës tuaj nuk mund të lejohet njëkohësisht pasi që nuk është përfunduar ende dhe mungon incizimi gjeodezik përfundimtarë për vendndodhjen e saktë të kolektorit çka mund të atakoj edhe kanalit elektrik të propozuar nga KEDS.

**Provë:** Kërkesa e konsumatorit date 25.10.2023 per revidim te Pëlqimit Elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike nr. 9387 datë 11.10.2023 dhe Njoftimi i datës 24.10.2023

Me datë 13.11.2023 KEDS përmes një përgjigje e refuzon kërkesën e palës për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me PEE dhe Zgjidhjen Teknike nr. 9387 datë 11.10.2023, duke theksuar se kërkesa e juaj per ndryshimin e mënyrës se kyçjes se trafostacionit tuaj është refuzuar dhe mbesin ne fuqi kushtet teknike te dhëna ne Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 9387 datë 11.10.2023. Ne arsyetimin e përgjigjes është theksuar se kërkesa juaj per revidim të zgjidhjes teknike përkatësisht kyçja ne linjën 10(20) kV duke formuar dy lidhëse(mufa) refuzohet sepse KEDS nuk e sheh te arsyeshme këtë zgjidhje teknike per shkak të problemeve teknike qe mund të shfaqen ne te ardhmen.

**Provë:** Përgjigjja e KEDS nr.10219 datë 13.11.2023





Me datë 20.11.2023 i pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it, aplikuesi brenda afatit ligjor paraqet ankesë pranë DMK-së në ZRRE, duke kontestuar refuzimin e kërkesës së tij nga ana e KEDS-it. Aplikuesi ne ankesën e tij thekson se linja e tensionit të mesëm 10(20)kV me kablo IPO 4x185mm<sup>2</sup> kalon nëpër parcelën tonë të ndërtimit. Me PEE me numër të protokolit 9387 dt. 11.10.2023 KEDS ka dhënë kushtet për ndërtimin e komplet linjës së tensionit të mesëm që sot lidh TS 408 dhe TS 409 duke krijuar sistemin hyrje dalje në trafostacionin tonë. Në parim ne kemi pranuar kushtet teknike edhe pse të vështira teknike dhe jo të arsyeshme, ku KEDS ka për qëllim që investitorët të eliminojnë rrjetin e tyre ekzistues. Por, komuna e Gjakovës, drejtorja e infrastrukturës ka refuzuar kërkesën tonë për ndërtimin e kanalit në rrugën Musa Zajmi e cila është shtruar me asfalt së fundi dhe nuk lejohet ndërtimi i kanalit dhe puseta. Me këtë ne kemi bërë kërkesë për revidim të Pëlqimit Elektroenergjetik ku do të na mundësohet të premë kabllin- linjën IPO për të krijuar sistemin hyrje dalje, por që KEDS ka refuzuar për arsyen se nuk e sheh te arsyeshme për shkak të problemeve që mund të shfaqen në të ardhmen.

**Provë:** Ankesa e datës 20.11.2023

Bordi i ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS-it, ka vërejtur se:

Investitori **Endrit Efendija, True Group SH.P.K** ka aplikuar për pëlqim elektroenergjetik ne KEDS për objektin afarist si dhe ka dorëzuar projektin elektrik. Sipas përmbledhjes së projektit vërtetohet se kërkesa për fuqi maksimale të njëkohshme për 28 njësi është  $P_{mnj}=144$  kW (sipas projektit elektrik). Me datë 11.10.2023 KEDS ka lëshuar PEE dhe Zgjidhjen teknike nr. 9387 ku ka theksuar se:

Bazuar në të dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar për veprimtarin afariste:

Objekt banesor, 28 njësi, Fuqia e transformatorit  $S_{int}=160$  kVA me fuqi maksimale të njëkohshme prej  $P_{mnj}=144$  kW (sipas projektit elektrik). Në PEE dhe ZT po ashtu janë përcaktuar edhe kushtet teknike të kyçjes si dhe mënyrës së furnizimit të aplikuesit. Furnizimi i trafostacionit ri me energji eklektike bëhet nga dalja "Elektrokosova me kod:81084020" nga NS 35/10(20) kV "Gjakova III". Ekzekutimi i kyçjes trafostacionit të ri të realizohet atë mënyrë që kablo ekzistuese prehet vendin e paraqitur në zgjidhjen teknike faqe 3 dhe e njëjta të tërhiqet deri te kthina dalëse e trafostacionit të ri. Nga kthina hyrëse e trafostacionit të ri realizohet linja e re me kablo të tipit XHE 49A 3x1x150 mm<sup>2</sup> deri te kthina dalëse e trafostacionit "Ts-9 me kod: përmes kanalit kabllorik me gypa dhe puseta sipas normave teknike dhe projektit elektrik të aprovuar nga Departamenti i Investimeve —KEDS. Trafostacioni ri TS 10(20)/0.4 kV duhet të jetë me fuqi instaluese  $S_n=160$  kVA i tipit "Blindë Metalike ose Murosur" me të gjitha pajisjet adekuate për këtë tip të trafostacionit dhe i ndërtuar vend të përshtatshëm me mundësi të qasjes së përhershme....

Bazuar në PE dhe Zgjidhjen Teknike të lëshuar nga KEDS, investitori me datë 18.10.2023 ka bërë kërkesë zyrtare në KK Gjakovë, lidhur me kërkesën për prerjen/gërmimin e rrugës sipas kërkesës së projektit të parapara me Zgjidhjen Teknike. Me datë 24.10.2023 Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka nxjerr njoftimin ku thuhet se:

Lidhur me kërkesën e Juaj me të cilën keni kërkuar të pajiseni me leje për kyçjen e objektit të banimit kolektiv në rrjetin nëntokësor të tensionit të mesëm 10(20) kV që ndodhet në rrugën





ARSIM RAMA në Z.K Gjakovë-Qytet konform- Pëlqimit Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknikë me nr. 9387 të datës 11.10.2023 të lëshuara nga KEDS, ju njoftojmë me sa vijon:

Aktualisht po punohet nga kompania rajonale K.R.U. Gjakova në projektin: Eliminimi i Ujërave të ndotura në Jug-Perëndim të Kosovë faza e III-të — Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve të Gjakovës, ku gjatësia e kolektorit kryesor është 3.0 km me profil DN 300 deri DN 400 dhe në këtë projekt është e përfshirë edhe rruga ARSIM RAMA dhe në segmentet ku ky kolektor kalon nëpër trotuare të ngarkuara me infrastruktura të shumta të cilat mund të pengojnë realizimin e tij, rekomandohet të behet zhvendosja e kolektorit në shiritin e rrugës andaj ekzekutimi i kanalit nëntokësor elektrik sipas kërkesës tuaj nuk mund të lejohet njëkohësisht pasi që nuk është përfunduar ende dhe mungon incizimi gjeodezik përfundimtarë për vendndodhjen e saktë të kolektorit çka mund të atakoj edhe kanalin elektrik të propozuar nga KEDS.

Me datë 25.10.2023 Investitori **Endrit Efendija, True Group SH.P.K**, ka parashtruar kërkesë në KEDS që të i behet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 9387 datë 11.10.2023 ku do të na mundësohet të behet prerja e kabllit- linjës IPO për të krijuar sistemin hyrje dalje pasi që Linja e tensionit të mesëm 10(20)kV me kablllo IPO 4x185mm<sup>2</sup> kalon nëpër parcelën tonë të ndërtimit. Aplikuesi në kërkesën e tij përveç kërkesës për prerje të kabllit ka potencuar edhe faktin se komuna e Gjakovës, drejtorja e infrastrukturës ka refuzuar kërkesën tonë për ndërtimin e kanalit në rrugën Musa Zajmi e cila është shtruar me asfalt së fundi dhe nuk lejohet ndërtimi i kanalit dhe pusetave. Pas kërkesës së aplikuesit për revidim të Zgjidhjes teknike dhe Pëlqimit elektroenergjetik, Departamenti për shërbime me konsumatorë në KEDS ka kthyer përgjigjen duke refuzuar kërkesën e aplikuesit me arsyetimin se: kërkesa juaj për revidim të zgjidhjes teknike përkatësisht kyçja në linjën 10(20) kV duke formuar dy lidhëse(mufa) refuzohet sepse KEDS nuk e sheh të arsyeshme këtë zgjidhje teknike për shkak të problemeve teknike që mund të shfaqen në të ardhmen. Bordi i ZRrE po ashtu gjatë analizës së përgjigjes së kthyer nga KEDS nr.10219 datë 13.11.2023 nuk ka vërejtur se KEDS ka potencuar qartë arsyen e mos lejimit të prerjes së kabllit 10(20) kV por që vetëm ka theksuar se mund të shfaqen probleme teknike në të ardhmen duke mos i arsyetuar dhe potencuar këto probleme të mundshme teknike.

Aplikuesi ka ofruar në ZRRE, PEE dhe ZT nr. 6728 date 29.06.2023 të lëshuar nga KEDS për një aplikues tjetër me të cilën vërtetohet se këtij aplikuesi i është lejuar prerja e kabllit 10(20)kV nëntokësor dhe krijimi i lidhëses (mufimit) e e cila nuk ka paraqitur problem si në rastin e kontestit të ngritur nga **Endrit Efendija, True Group SH.P.K**.

Bordi i ZRrE-së bazuar në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit konstaton se aplikuesi **Endrit Efendija, True Group SH.P.K** me rastin e aplikimit për kyçje ka vepruar konform nenit 8 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji elektrike si dhe nenin 9 të Metodologjisë së Taksave të kyçjes së OSSH-së e ku thuhet se: “Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo Konsumator Prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike”, kurse në paragrafin 3 nën paragrafin 3.1 të këtij neni thuhet se: Përdoruesit ekzistues ose të ardhshëm të sistemit të shpërndarjes duhet të marrin ofertën e kyçjes për kyçje në sistemin e shpërndarjes nga OSSH kur ndërtojnë objekte të reja që duhet të lidhen me sistemin e shpërndarjes. Në nenin 10 po ashtu janë të përcaktuara edhe fazat e procesit të kërkesës për kyçjes




dhe shqyrtimi i kërkesës së aplikuesit për kyçje në sistemin e shpërndarjes si dhe për modifikimin e kyçjeve saktuale andaj edhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka respektuar kushtet e përcaktuara në nenin 10.2 duke përgatitur ofertën për kyçje përkatësisht ka lëshuar PEE dhe ZT nr. 9387 datë 11.10.2023 me të cilat janë të përcaktuara të gjitha kushtet teknike të cilat duhet të plotësohen para kyçjeve saktuale edhe vendin ku do të bëhet kyçja, por që Bordi i ZRRE-së vëren se pas kërkesës së aplikuesit për revidim projekti e në të cilën janë paraqitur/bashkangjitur (njoftimi nga KK Gjakovë) edhe arsyet e pamundësisë së ekzekutimit të Zgjidhjes Teknike sipas propozimit të KEDS si dhe është dhënë zgjidhja e mundshme nga ana e aplikuesit duke propozuar që të bëhet prerja e linjës 10(20) kV, KEDS të njëjtën nuk e ka marrë parasysh me arsyetimin se kjo në të ardhmen mund të paraqesë probleme. Bordi i Zyres së Rregullatorit për Energji bazuar në të gjitha analizat e bëra e në veçanti njoftimin e komunës së Gjakovës mbi refuzimin e kërkesës së aplikuesit për ekzekutimin e punimeve sipas kërkesës në Zgjidhjen Teknike nr. 9387 datë 11.10.2023 konstaton se KEDS është dashur që të revidojë Pëlqim Elektroenergjetik si dhe Zgjidhjen Teknike për aplikuesin "**Endrit Efendija, True Group SH.P.K**" nr. 9387 datë 11.10.2023 dhe ti lejojë aplikuesit prerjen/mufimin e linjës kabllore 10(20) kV për krijimin e sistemit Hyrje/Dalje duke marrë të gjitha masat e parapara me Kodin e Matjes si dhe Kodin e Rrjetit të OSSH për përcaktimin e kushteve (normave) teknike të parapara për kyçjen e aplikuesit për operim stabil dhe të sigurtë të Sistemit të Shpërndarjes.


Bordi i Zyres së Rregullatorit për Energji pas analizave të bëra dëshimore dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Pëlqimi elektroenergjetik dhe Zgjidhja Teknike nr. 9387 datë 11.10.2023, kërkesën e aplikuesit date 25.10.2023 për revidim të PEE dhe Zgjidhjes teknike, përgjigja e KEDS nr.10219 datë 13.11.2023, PEE dhe ZT nr. 6728 date 29.06.2023, Përgjigja nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit date 24.10.2023 nga KK Gjakovë, Rregullën Për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si dhe Metodologjisë së taksave për kyçje të rrjetit të Shpërndarjes, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.


**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.





**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, Anëtare

  
Gani Buçaj, Anëtar

  
Arta Isufi, Anëtare

  
Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KEDS,
- Aplikuesit: Endrit Efendija, True Group SH.P.K dhe
- Arkivit të ZRRE-së.